



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI**

Nr. 582/Prot  
3

Tiranë, më 24.01.2018

**URDHËR**

Nr. 78/, datë 24.01.2018

**PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MENUTË USHQIMORE TË ÇERDHEVE DHE  
KOPSHTEVE PËR FËMIJËT 0-6 VJEÇ**

Mbështetur në Nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 46 pika 1 të Ligjit Nr. 10138, datë 11/05/2009 “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, relacionit Nr 582/2 prot, datë 24.01.2018, “Relacion mbi propozimin për ndryshimin e menusë për fëmijët 0-6 të çerdheve dhe kopshteve”, të përgatitur nga grupi i punës, në përputhje me udhëzuesit kombëtar të ushqyerjes së shëndetshme, nisur nga nevojat aktuale për të bërë disa përmirësime në menutë aktuale për fëmijët 0-6 vjeç në çerdhe dhe kopshte,

**MIRATOJ:**

1. Menunë 5-ditore, për fëmijët në çerdhe, foshnjat 6-8 muaj, pranverë – verë. (Shtojca 1.1, bashkëlidhur urdhërit).
2. Menunë 5-ditore, për fëmijët në çerdhe, foshnjat 8-10 muaj, pranverë – verë. (Shtojca 1.2, bashkëlidhur urdhërit).
3. Menunë 5-ditore, për fëmijët në çerdhe, foshnjat 10-12 muaj, pranverë – verë. (Shtojca 1.3, bashkëlidhur urdhërit).
4. Menunë 5-ditore, për fëmijët në çerdhe, foshnjat 6-8 muaj, vjeshtë – dimër. (Shtojca 2.1, bashkëlidhur urdhërit).
5. Menunë 5-ditore, për fëmijët në çerdhe, foshnjat 8-10 muaj, vjeshtë – dimër. (Shtojca 2.2, bashkëlidhur urdhërit).
6. Menunë 5-ditore, për fëmijët në çerdhe, foshnjat 10-12 muaj, vjeshtë – dimër. (Shtojca 2.3, bashkëlidhur urdhërit).
7. Menunë 5-ditore, për fëmijët 1-3 vjeç në çerdhe. (Shtojca 3, bashkëlidhur urdhërit).
8. Menunë 5-ditore, për fëmijët 3-6 vjeç në kopshte. (Shtojca 4, bashkëlidhur urdhërit)

9. Rekomandime për personelin e kujdesit dhe të kuzhinës në çerdhe. (Shtojca 5, bashkëlidhur urdhrin)
10. Të njoftohen strukturat përkatëse të Shëndetit Publik, bashkitë në të gjithë Republikën e Shqipërisë, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Qendror dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për menutë e miratuara 5-ditore të fëmijëve 0-6 vjeç, në çerdhe dhe kopshte.
11. Ngarkohen për për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri, të gjitha strukturat e përcaktuara në pikën 10 të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTRI  
Ogerta Manastirliu

REPUBLICA E SHQIPËRISE -  
SHTETI DHE MBROJTËS  
MINISTRIA E SHËNDETËSISE  
TIRANË